

V.A.L.E. RECYCLING SH.P.K
L87806501K

Pasqyrat financiare vjetore

per periudhen nga

01 Janar deri me 31 Dhjetor 2020

P E R M B A J T J A

- I. Bilanci kontabel**
- II. Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve**
- III. Pasqyra e fluksit te parave**
- IV. Pasqyra e ndryshimeve ne kapital**
- V. Shenimet shpjeguese**

- 1. Informacion i pergjithshem per shoqerine
- 2. Parimet e pergatitjes se pasqyrave financiare
- 3. Politikat kontabile kryesore
- 4. Mjetet monetare
- 5. Kerkesa te tjera te arketueshme
- 6. Inventari
- 7. Aktivitet afatgjate material
- 8. Te pagueshme ndaj furnitorve
- 9. Te pagueshme ndaj punonjesve
- 10. Detyrime tatimore
- 11. Kapitali
- 12. Rezultati i ushtrimit
- 13. Te ardhura nga arktiviteti
- 14. Materiale te konsumuara
- 15. Pagat e personelit
- 16. Shpenzime sigurime shoqerore dhe shendetesore
- 17. Shpenzime te tjera te shfrytezimit
- 18. Fitimi (humbja) neto e vitit financiar

Shenime

1. Informacion i pergjithshem per Shoqerine

Shoqeria “**V.A.L.E. RECYCLING**” sh.p.k. eshte shoqeri tregtare qe ushtron aktivitet ekonomik ne fushen e grumbullimit, administrimit, transportimit dhe perpunimit te mbetjeve urbane, mbetjeve te posaçme dhe mbetjeve spitalore etj

Shoqeria eshte regjistruar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, eshte pajisur me NIPT L28029301Q, me seli Gurez, Lac.

Shoqeria ka patur te punesuar mesatarisht 35 persona gjate vitit 2020.

2. Parimet e pergatitjes se pasqyrave financiare

(a) Deklarata e parimeve kontabel

Shoqeria mban regjistrimet kontabel dhe pergatit pasqyrat financiare ne perputhje me legjislacionin kontabel dhe tatimor ne Shqiperi.

Pasqyrat financiare jane pergatitur ne perputhje me Ligjin nr. 9228 date 29 Prill 2004 “Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe Standardet Kombetare te Kontabilitetit.

(b) Parimet e pergatitjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur mbi bazen e parimit te koston historike.

Politikat kontabel te meposhtme jane zbatuar per pasqyrat financiare.

(c) Monedha funksionale dhe raportuese

Keto pasqyra financiare jane pergatitur ne Leke (monedha Shqiptare) ne perputhje me legjislacionin kontabel ne Shqiperi.

3. Politikat kontabel kryesore

(a) Transaksionet ne monedha te huaja

Transaksionet ne monedha te huaja jane konvertuar ne Leke duke perdorur kursin e kembimit ne daten e transaksionit. Fitimet dhe humbjet nga kembimet per keto transaksione dhe rivleresimet me kursin e fundit te vitit te mjeteteve monetare dhe te drejtave dhe detyrimeve ne monedha te huaja jane njohur ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

(b) Mjetet monetare

Aktivitet monetare perbehen nga gjendja ne arke dhe ne llogarine bankare.

(c) Llogarite e arketueshme

Llogarite e arketueshme jane vleresuar me koston e tyre minus borxhin e keq, nqs ka.

(d) Vlersimi i inventarit

Njesia ekonomike ka vleresuar inventarin me vleren me te ulet midis kostos dhe vleres neto te e realizueshme

(e) Detyrime tregtare dhe te tjera

Detyrimet tregtare dhe te tjera jane paraqitur me koston e tyre.

(f) Aktivet afatgjate materiale

(i) Njohja dhe vleresimi

Aktivete materiale jane vleresuar me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvleresimi (nqs ka).

(ii) Amortizimi

Amortizimi njihet ne pasqyren e te ardhurave me metoden zbritese, me norma te cilat jane te peraferta me jetegjatesine mesatare te parashikuar te perdorimit.

Aktualisht shoqeria nuk ka llogaritur amortizim, pasi aktivet afatgjate materiale nuk jane vene ne perdorim pasi shoqeria eshte ne fazen e investimeve dhe aktivet afatgjate materiale jane ne proces instalimi dhe investimi .Amortizmi i aktiveve fillon kur ai eshte i gatshem per perdorim.

(g) Shpenzime per personelin

(i) Kontributet per sigurime shoqerore dhe te ngjashme

Shoqeria, gjate aktivitetit te saj normal, kryen pagesa ne emer te saj dhe aktualisht ka paguar kontributet per sigurimet shoqerore dhe shendetesore ne pajtim me legjislacionin ne fuqi. Kostot perkatese te bera ne emer te Shoqerise ngarkohen ne pasqyren e te ardhurave me ndodhjen e tyre.

(ii) Leje e zakonshme e paguar

Shoqeria njeh si nje shpenzim personeli ato kosto qe lidhen me lejen e zakonshme atehere kur eshte perdorur nga personeli perkates.

Lac, me 31/03/2021